



Republika e Kosovës
Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit
Institucija Ombudsmane • Ombudsperson Institution

Mr./Br./Mo. 12/13/2021
Nr.i fq/Bр.str./Nr.pg.
Data/Datum/Date: 17/08/2021

PRISHTINË-PRIŠTINA-PRISTINA



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT ME REKOMANDIME

Ex officio
Rasti nr. 381/2020

në lidhje me zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës

Për: Z. Albin Kurti, kryeministër, Qeveria e Republikës së Kosovës

Komisioni i Pavarur të Mediave

Z. Albert Zogaj, kryesues, Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Prishtinë, më 17 gusht 2021

Qëllimi

1. Ky rapport me rekomandime ka për qëllim identifikimin e akteve nënligjore të përcaktuara me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës, Gazeta Zyrتare e Republikës së Kosovës/nr.14/17 korrik 2019, Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: LMF)¹. Raporti vë në pah mungesën e respektimit të afateve ligjore për nxjerrjen e të gjitha akteve të parapara me ligjin në fjalë, nga ana e institucioneve përgjegjëse. Meqë deri më tani janë nxjerrë vetëm dy akte nënligjore nga 18 sosh sa janë paraparë, Avokati i Popullit u rekomandon institucioneve përkatëse nxjerrjen e tyre sa më shpejt që të jetë e mundur.

Baza ligjore

2. Avokati i Popullit, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës² (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit³, Gazeta Zyrتare e Republikës së Kosovës / nr. 16/26 qershor 2015, Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: Ligji për Avokatin e Popullit), i ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
 - 2.1 “Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike;” (neni 132, paragrafi 1, i Kushtetutës).
 - 2.2 “Avokati i Popullit mund të japë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore;” (neni 135, paragrafi 3, i Kushtetutës).
 - 2.3 “(...) me iniciativën e vet (ex officio) (...) nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut;” (neni 16, paragrafi 4, i Ligjit për Avokatin e Popullit).
 - 2.4 “t'i rekomandojë Qeverisë. Kuvendit dhe autoritetet e tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jodiskriminimit;” (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, i Ligjit për Avokatin e Popullit).
 - 2.5 “të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës;” (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, i Ligjit për Avokatin e Popullit).
 - 2.6 “t'i rekomandojë Kuvendit harmonizimin e legjislacionit me standarde ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut, si dhe zbatimin e tyre efektiv.” (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.9, i Ligjit për Avokatin e Popullit).

Rrethanat e rastit

3. Më 12 korrik 2019, LMF-ja është dekretuar nga presidenti i Republikës së Kosovës.

¹ gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=20844

² [https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702](http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702)

³ [https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10922](http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10922)

4. Më 17 korrik 2019, LMF-ja është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
5. LMF-ja në nenin 66 (Hyrja në Fuqi) ka përcaktuar: “*Ky ligj hyn në fuqi një (1) vit pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.*”
6. LMF-ja në nenin 65 (Aktet nënligjore për zbatimin e Ligjit) ka përcaktuar: “*Neni 65. Për zbatimin e këtij Ligji, në afat prej një (1) viti, nga hyrja në fuqi e këtij ligji. duhet të nxirren aktet nënligjore.*”
7. Më 26 qershor 2020, Avokati i Popullit ka iniciuar hetime me iniciativën e vetë (*ex officio*) duke u bazuar në nenin 16, parografi 4⁴, të Ligjit për Avokatin e Popullit.

Analiza e çështjes

8. LMF-ja është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 17 korrik 2019, ndërsa ka hyrë në fuqi një vit pas publikimit.⁵ Neni 65 obligon që aktet nënligjore duhet të nxirren brenda një viti pas hyrjes në fuqi të ligjit, rrjedhimisht afati për nxjerrjen e akteve është deri më 17 korrik 2021⁶.
9. Duke u nisur nga detyrimet që shteti i ka karshi fëmijëve, zbatimi adekuat i Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve kërkon urgjentisht edhe nxjerrjen e akteve të parapara nënligjore. Meqë deri më tanë janë nxjerrë vetëm dy akte nënligjore nga 18 sosh, Avokati i Popullit e rithekson nevojën e nxjerrjes së tyre sa më shpejt që të jetë e mundur.
10. LMF-ja për nga struktura është e ndarë në nëntë kapituj: Dispozitat e përgjithshme (I), Parimet e mbrojtjes së fëmijës (II), Mekanizmat institucionalë për të drejtat e fëmijës (III), Masat për mbrojtjen e fëmijës (IV), Mbrojtja e fëmijës në familje dhe komunitet (V), Mbrojtja e fëmijës nga shfrytëzimi ekonomik (VI), Format specifike të mbrojtjes së fëmijës (VII), Dispozitat ndëshkuese (VIII), dhe Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare (IX).
11. Aktet nënligjore të parapara me LMF rregullojnë 18 fusha të ndryshme që ndërlidhen me të drejtat e fëmijës dhe përbëjnë një ndër treguesit e zbatimit të tij. Ndonëse miratimi i ligjit shënon një hap të madh në fushën e të drejtave të fëmijëve, në mënyrë që ai të jetësohet dhe fëmijët realisht t'i gjëzojnë të drejtat e tyre, ligji duhet të zbatohet në tërsi dhe me seriozitet nga institucionet përkatëse.
12. LMF-ja në nenin 9 (Autoritetet për të drejtat e fëmijëve), parografi 3, ka përcaktuar: “*Struktura dhe mekanizmat institucionalë në nivel qendror dhe lokal, bashkëpunojnë dhe koordinojnë punën ndërmjet tyre për zbatimin e këtij ligji, të legjislacionit në fuqi dhe të politikave shtetërore për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës. Bashkërendimi i veprimeve të tyre për çështjet që lidhen me të drejtat e fëmijës, të propozuara në këtë ligj, përcaktohen me akt nënligjor, të miratuar nga Qeveria, me propozim te Zyrës së Kryeministrat.*”

⁴ Avokati i Popullit ka kompetencë të bëjë hetime qoftë për t’iu përgjigjur ankesës së parashtruar apo me iniciativën e vet (*ex-officio*), nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet e paraqitura me parashtresë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjeter, ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

⁵ LMF, nen 66.

⁶ LMF, nen 65.

13. LMF-ja në nenin 9 (Autoritetet për të drejtat e fëmijëve), paragrafi 4, ka përcaktuar: “*Strukturat dhe mekanizmat institucionalë bashkëpunojnë me organizatat joqeveritare për realizimin e politikave për të drejtat e fëmijës, si dhe për ofrimin e shërbimeve të nevojshme për mbrojtjen e tyre, të përcaktuar me akt nënligjor, të miratuar nga Qeveria, me propozim të Ministrisë përkatëse për Mirëqenie Sociale, në bashkëpunim me Zyrën për Qeverisje të Mirë.*”
14. LMF-ja në nenin 10 (Roli i Institucionit të Avokatit të Popullit për mbrojtjen e fëmijës), paragrafi 3, ka përcaktuar: “*Cdo fëmijë, person apo grup i personave mund t'i parashtrojë ankesë Avokatit të Popullit lidhur me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës sipas procedurave të parapara me legjislacionin në fuqi. Avokati i Popullit nxjerr Rregullore për mënyrën e ankesës së fëmijës, siç përcaktohet në këtë ligj.*”
15. LMF-ja në nenin 18 (Këshilli për të drejtat e fëmijës), paragrafi 2, ka përcaktuar: “*Rregullat e procedurës së Këshillit për të Drejtat e Fëmijës rregullohen me akt nënligjor të propozuar nga njësia përkatëse për Qeverisje të Mirë dhe të miratuar nga Qeveria.*”
16. LMF-ja në nenin 20 (Ekipi për të drejtat e fëmijës), paragrafi 2, nënparagrafi 2.7, ka përcaktuar: “*Mënyra e themelimit dhe funksionimit të Ekipeve për të drejtat e fëmijës rregullohet me akt nënligjore, i cili miratohet nga Qeveria me propozim të Ministrisë përkatëse për Administrimin e Pushtetit lokal dhe Njësisë përkatëse Zyra e Kryeministratit.*”
17. LMF-ja në nenin 21 (Themelimi i tryezave multidisiplinore për ndihmë në menaxhimin e rastit), paragrafi 2, ka përcaktuar: “*Procedurat e punës, në tryezat multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rasteve, të udhëhequra nga menaxheri i rastit, në koordinim dhe bashkëveprim me strukturat dhe shërbimet përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës. Veprojnë mbi bazën e procedurave të detajuara që do të përcaktohen me akt nënligjor, që propozohet nga Ministria përkatëse për Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe aprovohet nga Qeveria.*”
18. LMF-ja në nenin 26 (Detyrimi ligjor për raportim), paragrafi 6, ka përcaktuar: “*Qeveria e Republikës së Kosovës, sipas propozimit të Ministrisë përkatëse për Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe Ministrisë përkatëse për Punë të Brendshme nxjerr akt nënligjor që rregullon procedurat efektive për identifikimin, raportimin, referimin, shfrytëzimin, neglizhimin dhe abuzimin e fëmijës si dhe për mbrojtjen e fëmijës në situatë rruge.*”
19. LMF-ja në nenin 30 (Shtëpitë për mbrojtjen e fëmijës), paragrafi 7, ka përcaktuar: “*Organizimi dhe fushëveprimi i shtëpive për mbrojtjen e fëmijës rregullohet me akt nënligjor të propozuar nga ministria përkatëse për Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe të miratuar nga Qeveria.*”
20. LMF-ja në nenin 43 (Mbrojtja e fëmijës nga substancat e dëmshme dhe të ndaluara), paragrafi 4, ka përcaktuar: “*Masat e duhura mbrojtëse dhe parandaluese, përfshirë edhe avokimin e një mënyre të shëndetshme të jetesës dhe dekurajimin e çdo lloj abuzimi me substanca narkotike dhe psikotrope, rregullohen me akt nënligjor të miratuar nga Qeveria, me propozim nga ministritë përkatëse për shëndetësinë.*”

21. LMF-ja në nenin 44 (Ndalimi i pjesëmarrjes në klubet e natës dhe lojërave të fatit), paragrafi 4, ka përcaktuar: “*Masat e duhura parandaluese dhe mbrojtëse për ndalimin e fëmijës. sipas paragratit 1. të këtij neni, rregullohen me akt nënligjor të miratuar nga Qeveria, me propozim nga Ministria përkatëse për Punë të Brendshme.*”
22. LMF-ja në nenin 45 (Mbrojtja e fëmijës në masmedia), paragrafi 8, ka përcaktuar: “*KPM në bashkëpunim me institucionet e tjera me akt nënligjor përcakton mënyrat e mbrojtjes së Fëmijëve në masmedia me theks të veçantë për fëmijët të cilët janë nën përkujdesje institucionale.*”
23. LMF-ja në nenin 46 (Mbrojtja e fëmijës me aftësi të kufizuara), paragrafi 4, ka përcaktuar: “*Fëmijës me aftësi të kufizuara mund t'i ofrohet shërbimi edukativ, shëndetësor apo rehabilitues, në përputhje me nevojat specifike, në një komunë tjetër nga ajo ku jeton dhe që përmblush kriteret për këtë qëllim. Shpenzimet, në këtë rast, mbulohen nga buxheti i të dyja njësive të vetëqeverisjes lokale. Rregullat dhe procedurat për mbulimin e këtyre shpenzimeve përcaktohen me akt nënligjor të miratuar nga Qeveria, me propozimin e ministrisë përkatëse për çështje sociale, në bashkëpunim me ministrinë përkatëse për shëndetësi dhe ministrisë përkatëse për Arsimin.*”
24. LMF-ja në nenin 50 (Mosha minimale e fëmijës për punësim), paragrafi 6, ka përcaktuar: “*Parandalimin dhe ndalimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijëve në Kosovë, rregullohet me udhëzim administrativ të nxjerrë nga Qeveria, me propozim të ministrisë përkatëse për punë dhe mirëgenie sociale.*”
25. LMF-ja në nenin 53 (Masat kundër faqeve të internetit me përbajtje pornografike dhe të atyre që dëmtojnë shëndetin dhe jetën e fëmijës), paragrafi 3, ka përcaktuar: “*Qeveria, me propozimin e Ministrisë përkatëse për Punë të Brendshme, nxjerr akt nënligjor, lidhur me mbrojtjen e fëmijëve nga internet-kafetë dhe videolojërat, duke përfshire masat specifike ndaj përbajtjeve pornografike, ndëshkimin e abuzuesve me fëmijë në internet, reduktimin e qasjes së fëmijës në materiale të dëmshme për shëndetin dhe jetën e tyre, ofrimi i ndihmës për fëmijën që është në rrezik nga të gjitha format e dhunës përmes internetit.*”
26. LMF-ja në nenin 55 (Drejtësia mike ndaj fëmijës), paragrafi 4, ka përcaktuar: “*Qeveria me propozimin e Ministrisë së Drejtësisë në bashkëpunim me Ministrinë përkatëse të Punëve të Brendshme dhe Ministrisë përkatëse të Punës dhe Mirëgenies Sociale, miraton akt nënligjor me të cilin do të rregullohen të drejtat e fëmijës në procedurë administrative dhe gjyqësore. Si dhe për ndihmën ligjore dhe qasjen në organet e drejtësisë, për realizimin e ndihmës juridike gjegjësisht për drejtësinë mike ndaj fëmijëve, bazuar në udhëzimin e Këshillit të Evropës për Drejtësinë Mike ndaj Fëmijëve.*”
27. LMF-ja në nenin 57 (Ndihma mjekësore dhe psikologjike, rehabilitimi dhe masat përiintegrime), paragrafi 10, ka përcaktuar: “*Njësia përkatëse për Shëndetësi, Punë dhe Mirëgenie Sociale, në kuadër të komunës, obligohet që të sigurojë buxhet për një fond të veçantë për të trajtuar emergjencat e rasteve të fëmijës në nevojë, për mbrojtjen dhe ngritjen e shërbimeve të emergjencës sipas standardeve të përcaktuara me akt nënligjor të miratuar nga Qeveria dhe të propozuar nga ministria përkatëse për shëndetësi.*”

28. LMF-ja në nenin 58 (Personat e dënuar për abuzim seksual apo shfrytëzim të fëmijës), paragrafi 2, ka përcaktuar: “*Këshilli Gjyqësor i Kosovës me akt nënligjor përcakton rregullat dhe procedurat për mbajtjen e bazës së të dhënave me ADN-të e personave të dënuar për veprat penale kundër integritetit seksual. Në këtë bazë të të dhënave me ADN-të duhet të përfshihen edhe personat e dënuar për këto vepra penale, pa marrë parasysh nëse viktimat e tyre janë fëmijë ose të rritur.*”
29. LMF-ja në nenin 63 (Edukimi për mbrojtjen e fëmijës), paragrafi 6, ka përcaktuar: “*Qeveria, sipas propozimit të Ministrisë përkatëse për Arsim, Shkencë dhe Teknologji, nxjerr Udhëzim Administrativ, lidhur me realizimin e të drejtave të përcaktuara me këtë ligj, si dhe siguron programe, të cilat promovojnë edukimin, rritjen e ndërgjegjësimit, lidhur me pasojat degraduese të ndëshkimit trupor dhe programe prindërore, që promovojnë mënyrat jo të dhunshme të disiplinimit në familje dhe shkollë, si dhe mbrojtjen e fëmijës nga dhuna dhe abuzimi.*”

Konstatimet

30. Avokati i Popullit vëren se Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës ka hyrë në fuqi më 17 korrik 2020, ndërsa zbatimin e tij institucionet përkatëse shtetërore, një vit nga hyrja në fuqi e këtij ligji, janë të obliguara t'i nxjerrin aktet nënligjore të parapara në nenet: 9, 10, 18, 20, 21, 26, 30, 43, 44, 45, 46, 50, 53, 55, 57, 58 dhe 63.
31. Avokati i Popullit vëren se që nga hyrja në fuqi e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, për zbatimin e tij janë nxjerrë aktet nënligjore të përcaktuar në nenin 10, paragrafi 3⁷, dhe në nenin 55, paragrafi 4⁸.
32. Avokati i Popullit vëren se që nga hyrja në fuqi e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës ende nuk janë nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve: 9, 18, 20, 21, 26, 30, 43, 44, 45, 46, 50, 53, 57, 58 dhe 63.
33. Avokati i Popullit vëren se nen 65 i Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës është një nen i rëndësishëm, i cili parasheh afatin ligjor prej një viti nga hyrja në fuqi e ligjit, për nxjerrjen e akteve nënligjore, për të siguruar zbatimin e ligjit në praktikë. Rrjedhimisht, nxjerra e këtyre akteve, pos të tjerash, e mundëson: bashkërendimin e autoriteteve përkatëse në nivel qendror dhe lokal; funksionimin e Këshillit për të drejtat e fëmijës; themelimin dhe funksionimin e Ekipave për të drejtat e fëmijës; funksionimin e themelimit të tryezave multidisiplinore për ndihmë në menaxhimin e rastit; organizimin dhe fushëveprimin e shtëpive për mbrojtjen e fëmijës; marrjen e masave të duhura në mbrojtjen e fëmijës nga substancat narkotike dhe psikotrope; marrjen e masave të duhura parandaluese dhe mbrojtëse në ndalimin e pjesëmarrjes në klubet e natës dhe në lojërat e fatit; mënyrat e mbrojtjes së fëmijëve në masmedia me theks të veçantë për fëmijët të cilët janë nën përkujdesje institucionale; marrjen e masave të duhura për mbrojtjen e fëmijëve nga internet-kafetë dhe video-lojërat, duke përfshirë masat specifike ndaj përbajtjeve pornografike, ndëshkimin e abuzuesve me fëmijë në internet, reduktimin e qasjes së fëmijës në materiale të dëmshme për shëndetin dhe jetën e tyre, ofrimi i ndihmës për fëmijën që është në rrezik nga të gjitha format e dhunës përmes internetit.

⁷ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=24140>

⁸ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=36550>

34. Avokati i Popullit, bazuar në atë që u tha më sipër, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: “*Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore.*” Sipas kuptimit të nenit 18, paragrafi 1.2, të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit: “*(...) ka përgjegjësi të têrheq vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëj rekomandime që t'u jepet fund rasteve të tilla (...);*” si dhe paragrafi 1.7 i po këtij nenit: “*Të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi [...].*”

Prandaj, Avokati i Popullit i

REKOMANDON

Qeverisë së Republikës së Kosovës:

1. Për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, të nxjerrë aktin nënligjor të paraparë në nenin 9, paragrafi 3, të këtij ligji.
2. Për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, të nxjerrë aktin nënligjor të paraparë në nenin 9, paragrafi 4, të këtij ligji.
3. Për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, të nxjerrë aktin nënligjor të paraparë në nenin 18, paragrafi 2, të këtij ligji.
4. Për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, të nxjerrë aktin nënligjor të paraparë në nenin 20, paragrafi 2, nënparagrafi 2.7, të këtij ligji.
5. Për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, të nxjerrë aktin nënligjor të paraparë në nenin 21, paragrafi 2, të këtij ligji.
6. Për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, të nxjerrë aktin nënligjor të paraparë në nenin 26, paragrafi 6, të këtij ligji.
7. Për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, të nxjerrë aktin nënligjor të paraparë në nenin 30, paragrafi 7, të këtij ligji.
8. Për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, të nxjerrë aktin nënligjor të paraparë në nenin 43, paragrafi 4, të këtij ligji.
9. Për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, të nxjerrë aktin nënligjor të paraparë në nenin 44, paragrafi 4, të këtij ligji.
10. Për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, të nxjerrë aktin nënligjor të paraparë në nenin 46, paragrafi 4, të këtij ligji.
11. Për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, të nxjerrë aktin nënligjor të paraparë në nenin 50, paragrafi 6, të këtij ligji.
12. Për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, të nxjerrë aktin nënligjor të paraparë në nenin 53, paragrafi 3, të këtij ligji.
13. Për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, të nxjerrë aktin nënligjor të paraparë në nenin 57, paragrafi 10, të këtij ligji.

14. Për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, të nxjerrë aktin nënligjor të paraparë në nenin 63, paragrafi 6, të këtij ligji.

Këshillit Gjyqësor të Kosovës:

1. Për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, të nxjerrë aktin nënligjor të paraparë në nenin 58, paragrafi 2, të këtij ligji.

Komisionit të Pavarur të Mediave:

1. Për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, të nxjerrë aktin nënligjor të paraparë në nenin 45, paragrafi 8, të këtij ligji.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“*Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim ne Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkeseve të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqes atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuar në pajtim me ligj*”) dhe në pajtim me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“*Autoritete, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkësë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë*”), ju lutemi mirësish të na informoni për veprimet që do t'i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.


Me nderime,

Naim Qelaj
Avokat i Popullit